



Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova, Sh.A, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall :

## KONKURS

**Titulli I Pozitës- Zyrtar/e Për Projektim dhe Zhvillim**

**Numri i pozitave: 2 ( dy)**

**Kohëzgjatja e punës:** Në kohë të caktuar/ Puna Provuere gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :**

- Ndihej në hartimin e projekteve për zgjerimin e rrjetave të reja në KRU "Gjakova" Sh.A.
- Ndihej në hartimin e projekteve për ndertimin e objekteve të reja hidrondertimore në KRU "Gjakova" Sh.A.
- Ndihej në hartimin e projekteve mbi mirëmbajtjen dhe reabilitimin e sistemeve egzistuese të rrjetit të ujësjetës
- Ndihej në zbatimin dhe zhvillimin e projekteve të kompanisë;
- Ndihej në mirëmbajtjen e sistemit të dhënave të projekteve të kompanisë;
- Ndihej në dorëzimin e kohe dhe cilësia e raporteve të aktivitetit sektorial të kompetencës.
- Ndihej në përmirësimin e sektorit të zbatimit të projekteve të KRU Gjakova;
- Ndihej në menaxhimin, përditësimin e bazës së të dhënave të projekteve të kompanisë në kohe dhe mënyrë profesionale;
- Kryen detyrat e dhëna në kohe dhe mënyrë profesionale;
- Ndihej në zhvillimin dhe mbajtjen e standardeve të qëndrueshme për raportimin e statusit të projektit .
- Ndihej në sigurimin dhe respektimin e standardeve të cilësisë dhe rishikimit të rezultateve të projektit sipas detyrës dhe kompetencës;
- Ndihej dhe ruan dokumentacionin dhe procedurat e sakta dhe të plota të identifikuara për të gjithë projektin (hapat) në lidhje me funksionalitetin apo cilësitë respektive;
- Ndihej në projektimin, incizimin dhe regjistrimet e asetëve deri në vlerësimin e gjendjes
- Si dhe detyra tjera të punës të caktuara nga punëdhënësi

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.**

- Përgatitja profesionale/Shkollore- Fakultetin e Ndërtimtarisë, Drejtimi- Hidroteknikë/Konstruktiv.
- Preferohet përvoja e punës 2 vjeçare që ndërlidhet me pozitën apo të ngjashme.
- Aftësi të mira organizative dhe koordinuese.
- Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit.
- Njohja e punës me kompjuter ( Microsoft office)
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.

**Paga mujore:** Sipas Rregullores.

**Informata të përgjithshme :**

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Procedura për aplikim-** Aplikacioni ( formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3.CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit( kopja e noterizuar), si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati i konkurrimit është nga data: 13/08/2020 deri me 27/08/2020. Adresa e zyrës** Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë-Kosovë.

**Vërejtje:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.